

Këshilltare Ligjore e Gjykatës së Lartë

Evriklejda SEMANI u lind në Berat, më 12 Nëntor 1985. Ajo është e martuar dhe ka një vajzë.

Ka kryer studimet e larta në Drejtësi në vitet 2004-2008 në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Tiranës. Nga tetori i vitit 2009 deri në tetor të vitit 2014 ka ushtruar profesionin e juristit pranë Ujësjetllës-Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a. Nga tetori i vitit 2014 deri në tetor të vitit 2019 ka ushtruar profesionin e Avokatit të Shtetit pranë Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit.

Në vitin akademik 2019 - 2020 ka ndjekur studimet pranë Shkollës së Magjistraturës, në profilin Këshilltar Ligjor.

Me vendimin Nr.557 datë 12.11.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor e emëroi Znj.SEMANI, Këshilltare Ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë.